


SHEHID HASAN EL BENNA



POROSIA
ISLAMIE

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshiruesit!

POROSIA ISLAME

Imam Esh-Shehid
Hasan el-Benna

HASAN EL BENNA (1906 - 1949)

Dijetari dhe revolucionari i shquar, Shehid Hasan El Benna, u lind më 1906 në qytetin Muhmudie të Egjiptit. Rrjedh nga një familje fetare, prej nga i fitoi njohuritë e para për Islamin. Me qëllim të zgjerimit të njohurive të veta islame, u regjistrua në shkollën fetare “*Ruzhdije*” në të cilën rol vendimtar në formimin e personalitetit të tij islam luajti dijetari i mirënjohur Muhammed Zehra. Si shtatëmbëdhjetëvjeçar studimet i filloi në shkollën për mësues, e me kryerjen e saj shkollimin e vazhdon në “Dâr-ul-Ulûm” të Kajros. Ai gjatë shkollimit të vet, e kuptoi esencën e imperializmit kolonialist dhe të gjitha të këqijat, të cilat ai ia shkaktonte popullit musliman dhe, bashkë me disa shokë të tij të ngushtë, vendosi të themelojë organizatën “Vëllezërit Muslimanë” - që do ta shpëtonte popullin musliman nga thundra imperialiste.

Numri i ithtarëve të kësaj organizate brenda por edhe jashtë Egjiptit dita-ditës shtohet, kështu që lëvizja mori një karakter botëror. Që këtu “Vëllezërit Muslimanë” filluan haptazi ta kritikojnë pushtetin egjiptas dhe politikën e imperializmit kolonialist, që e shtypte dhe përçante Ummetin islam.

Për shkak të kësaj, në vitin 1948 qeveria egjiptase urdhëroi ndalimin e veprimtarisë së “Vëllezërve Muslimanë” dhe konfiskimin e tërë pasurisë së kësaj lëvizjeje.

Përkundër kësaj ndalese, “Vëllezërit Muslimanë” në mënyrë ilegale e vazhduan aktivitetin e tyre. Kjo solli deri te ndjekja, burgosja dhe vrasja e një numri shumë të madh të ithtarëve dhe aktivistëve të kësaj lëvizjeje (që është duke ngjarë edhe në ditët e sotme e për të cilën edhe ne jemi dëshmitarë).

Më 12 shkurt 1949, një person “i panjohur” hap zjarr nga revolja drejt veturës në të cilën gjendej Hasan El Benna, dhe e plagos

atë. Ashtu të plagosur e dërgojnë në spital, ku me urdhërin e pushtetit largohet i tërë personeli, dhe atë që nuk pati sukses ta bëjë atentatori, e bënë marionetat egjiptase të imperializmit perëndimor. Kështu, në shtratin e spitalit, nga dora e tagutëve, ra Shehid Hasan El Benna.

Kjo, në pika të shkurta, ishte veprimtaria e Hasan El Bennës si udhëheqës i “Vëllezërve Muslimanë”, njëres nga lëvizjet më eminente islame. Në fund duhet përmendur edhe veprimtarinë e tij në lëmin e shkrimit, ku si vepër më e njohur është vëllimi i punimeve të tija për Islamin, me emrin “*Resail*”.

HYRJE

Me siguri keni pasur rast që me njerëz të bisedoni rreth problemeve të ndryshme. Gjatë kësaj është dashur të jeni të regjur, në mënyrë që temën e ligjëratës ta shpjegoni bindshëm, t'i shprehni të gjitha aspektet e mundshme dhe t'i vërtetoni supozimet tuaja saktë e qartë; por megjithatë ndonjëherë e keni ndërë veten të hutuar dhe keni vërejtur se asnjëri nga dëgjuesit nuk e ka kuptuar ligjëratën tuaj, e as domethënien e saj.

Unë këtë e kam vërejtur shumë herë, ndaj mendoj se kjo ndodhë për dy arsye:

E para, për arsye se çdo person ka udhë të ndryshme të të kuptuarit, inteligjenca dhe fuqia e të kuptuarit janë të ndryshme nga personi në person, dhe e dyta se tema e ekspozuar është e ngatërruar dhe e pashpjeguar sa duhet, edhe pse ligjëruesi është përpjekur që ta komentojë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

KRITERI I TË GJYKUARIT

Unë, në këtë ligjëratë dëshiroj që, qartë dhe në detaje, ta shpjegoj jo vetëm natyrën e thirrjes së “Vëllezërve Muslimanë”, por gjithashtu edhe qëllimin, synimin, veprimin dhe kuptimin e saj.

Kisha dëshiruar që, para së gjithash, t'i parashtroj kriteret në bazë të të cilëve ligjërimi im do të jetë më i kuptueshëm. Mendoj se rruga më e drejtë është që kriteret tona t'i shpjegojmë me anë të Librit Hyjnor, të cilit të gjithë duhet t'i jemi besnikë dhe në bazë të udhëzimeve të të cilit duhet të jetojmë.

Populli im!

Kur'ani Famëlartë është libër i qartë dhe i kuptueshëm, në të cilin janë të përfshira jo vetëm parimet e fesë, por edhe parimet themelore të drejtësisë sociale dhe të dispozitave ligjore. Kur'ani po ashtu përmban edhe urdhëresa e ndalesa.

A u përmbahen muslimanët urdhërave Kur'anorë?

A u besojnë ata ligjshmërive Hyjnore të përmbledhura në Te dhe a luftojnë për zbatimin e këtyre ligjshmërive? A e kuptojnë ata objektivitetin e Kur'anit? A përfshihet një sferë e jetës së tyre në parimet sociale të inkuadruara në Te?

Nëse përgjigja është afirmative, atëherë t'i lëmë argumentet anash, sepse vërtetë muslimanët me këtë rast kanë gjykuar kobin e jetës së sotme, e janë nisur në rrugën e së mirës. Mirëpo, nëse muslimanët janë larg nga udhëzimet Kur'anore, mësimet e Tija, duke i përfshirë urdhëresat e ndalesat, atëherë detyrë jona është që para së gjithash veten, e mandej edhe të afërmit tanë, t'i kthejmë kah shtegu i së Vërtetës, udhës së Kur'anit.

KUPTIMI I JETËS SIPAS KUR'ANIT

Duke e përcaktuar kuptimin e vërtetë të jetës, Kur'ani i udhëzon njerëzit në qëllimin e ekzistimit. Kështu p.sh. duke e shqyrtuar problemin e njerëzve, për të cilët problemi i vetëm për ekzistim është të ngrënit, të pirët, të kënaqurit si dhe të fituarit e të grumbulluarit e të mirave materiale të kësaj bote, në Kur'an thuhet:

“... E ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri”. (Kur'ani, 47:12)

Duke folur se është iluzore ajo të cilën njerëzit e lakmojnë në këtë botë, Kur'ani thotë:

“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, ndaj djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë”. (Kur’ani, 3:14)

Dhe së fundi ka edhe një tip njerëzish që shkaktojnë ngatërresa, bëjnë dredhi, shkaktojnë kaos. Për ata është thënë:

“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (pse në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet, ai në tokë vepron të bëjë shkatërrim në te, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)”. (Kur’ani, 2:204-205)

Një jetë e tillë nuk u përngjan mu’minëve. Allahu ka shtruar para tyre detyra shumë të rëndësishme si dhe përgjegjësi dhe kërkesa për disiplinë maksimale. Prej tyre kërkohet që ta udhëheqin njerëzimin kah e Vërteta, t’i ftojnë njerëzit për besnikëri ndaj Allahut dhe me dritën e Islamit ta shndrisin tërë botën.

Atyre u janë drejtuar këto fjalë të Allahut:

“O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurone. Bëni punë të mira (të dobishme), se do të gjeni shpëtim. Luftoni me një luftë të denjë për hir të Allahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë e edhe ky (Kur’an) ju quajti muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatën, përmbahuni me Allahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është”. (Kur’ani, 22:27-78)

Kjo do të thotë se Kur'ani u është drejtuar muslimanëve, që të jetojnë në frymën e Kur'anit dhe që me anë të Kur'anit t'i ftojnë të humburit, në udhën e drejtë të së Vërtetës. Detyra e të udhëhequrit të gjinisë njerëzore, drejt shpëtimit dhe lumturisë në të dy botërat, u takon musli- manëve e jo të tjerëve.

Kultura dhe civilizimi islam duhet të pranohet nga mbarë njerëzimi, në mënyrë që gjinia njerëzore të jetë e lumtur.

Allahu ua ka caktuar muslimanëve, si detyrë të shenjtë-*farz* dhe si qëllim të përhershëm, që t'i plotësojnë detyrat islame dhe t'i ftojnë njerëzit në udhën e Islamit. E tërë jeta e mu'minit duhet t'i kushtohet të Vërtetës dhe zgjerimit të së Vërtetës së Islamit në zemrat e njerëzve:

“Allahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. (Allahu dha) Premtimin të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhil e Kur'an. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzonju tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh.” (Kur'ani, 9:111)

Muslimanët e parë, por edhe shumë të tjerë më vonë, jetën e tyre ia kushtuan suksesit të misionit islam; e ata, në dhëntë Zoti, i pret dhurata e Allahut xh.sh. Bartësit dhe përhapësit e idesë islame i kishin cilësitë më të larta njerëzore, ndërsa admirimin e vet të flaktë për Islamin, dinin që në mënyrë këmbëngulëse t'ua bartin të tjerëve. Jeta e tyre ishte mishërim i virtyteve. Ata ishin bartësit e civilizimit dhe të kulturës së popujve islamikë, të pasuruar me dituri dhe me urtësi.

Imperializmi kurrë nuk mund të japë cilësi të tilla çfarë dha Islami.

SI I JANË KUSHTUAR MUSLIMANËT KËTIJ QËLLIMI?

A e kuptojnë muslimanët drejt domethënien e Librit Hyjnor? A kanë përvojë të mjaftueshme, a është shpirti i tyre i mbushur me pastërti? A janë çliruar nga robërimi i materies? A janë ngritur mbi punët e ndyra dhe gënjeshttrat? A drejtojnë vëmendjen e vet kah Qenia Hyjnore e Krijuesit të të gjithë botërave? A e ndjekin muslimanët fjalën e Allahut? A shkojnë udhës të cilën Ai e ka rrëfyer; a e interpretojnë dhe a e përhapin Fenë e Allahut xh.sh. dhe pastërtinë kristalore të burimeve të Sheriatit? A janë bërë njerëzit robër të lakmisë dhe të makutërisë, a është bërë ky i vetmi qëllim i jetës së tyre, siç është edhe kënaqja në ushqim të mirë, vozitja në vetura të shpejta, veshja me rroba të shtrenjta e të stolisura, gjumi i mirë dhe takimi me gra të bukura?

Poeti ka thënë:

“Ata vyshken në jetën e bollëkut të ngazëlluar nga lakmia dhe epshet, me dëshirë që ta dëshmojnë emrin e tyre të mirë. e të tillët janë larg nga e vërteta”.

Prandaj vërtetëdashësi i vërtetë, i Dërguari i Zotit, ka thënë:

“Robërit e botës materiale, robërit e parave dhe robërit e veshjes, janë të mallkuar!”

QËLLIMI ËSHTË ÇËSHTJE THELBËSORE E ME VEPRIM SHKOJMË DREJT TIJ

Qëllimi është faktor thelbësor që të shpie në rrugë të drejtë. Mirëpo, kuptimi i vërtetë i jetës edhe më tej është i fshehur për një pjesë të madhe të popullit tonë. Kjo mosdije duhet të zhduket dhe të ndriçohet e Vërteta. Ne duhet publikisht të

gjithëve t'ua paraqesim idetë tona dhe roli ynë në procesin e jetës dhe të historisë duhet të manifestohet në kuptimin e mirëfilltë të tij.

BAZAT E QËLLIMIT TONË

“Vëllezërit Muslimanë” dëshirojnë që idenë islame, në mënyrë të plotë, t'ua sqarojnë të gjithë muslimanëve të botës dhe ata, përmes fuqisë lëvizëse të Islamit, t'i njohin obligimet e veta. “Vëllezërit Muslimanë” nuk i kanë krijuar parimet e Islamit, e as që ato janë krijuar në ëndrra, në meditime e në imagjinatë. E tërë kjo është paraqitur në dritën e Kur'anit dhe në fjalët e Pejgamberit a.s. të ndershëm. Sqarimet e idesë së pastër islame bëhen vetëm përmes këtyre burimeve, në jetën dhe veprën e Muhammedit a.s., as'habëve të tij dhe halifëve të parë islamë. Kjo ka qenë periudha ideale për të kuptuarit e Islamit dhe të mësimit islam.

Muslimanët e besimit të vërtetë, të cilët e studiojnë Islamin, do të duhej që pashmangshmërisht të tregojnë interesim në luftën për realizimin e idealeve islame. Mirëpo, do të ketë edhe prej atyre, të cilët do të tërhiqen nga rruga e drejtë, ndërsa midis nesh dhe atyre do të ketë greminë, e gjykimi do të jetë Libri i Allahut xh.sh. që ndanë të vërtetën prej rrenës:

“Zoti ynë, vendos mes nesh dhe mes popullit tonë gjykimin tënd të drejtë, se Ti je më i miri gjykatës”. (Kur'ani, 7:89)

PËRFUNDIM

Shumica nga muslimanët kërkojnë sqarime për ne, e ne u themi se tërë energjinë tonë, tërë mjetet materiale, e edhe jetën tonë, ia kemi kushtuar detyrës së madhe të realizimit të lumturisë dhe mirëqenies në jetën materiale dhe shpirtërore të të gjithë muslimanëve. Dhe për shkak të këtij që-llimi, të cilin e realizojmë vetëm e vetëm për të mirën e popullit tonë, për të mirën e vëllezërve tanë, ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë pasurinë dhe jetën tonë. Në luftën për popullin tonë dhe vëllezërit tanë, ne veten dhe familjet tona i qesim në plan të dytë. Dhe prandaj është dëshira imja e madhe që popullin tonë, vëllezërit tanë të pavendosur t'i informoj, në mënyrë të drejtë, për ata njerëz të mrekullueshëm, muxhahidët, të cilët janë vigjilentë, kur të tjerët flejnë, të cilët janë në punë kur të tjerët pushojnë në kotje të ëmbël. Çdonjëri nga ata, muxhahidë, është i zënë deri natën vonë, në punë për Islamin dhe në gjetjen e zgjidhjeve për problemet që pasojnë.

Programi i këtyre të rinjve të mrekullueshëm është i përhershëm, ata zhvillojnë punë sociale, ndërsa potencialet e veta materiale i orientojnë kah shërbimi i idesë së vet dhe misionit të vet. Ata zotërojnë guximshëm çdo pengesë dhe thonë: “Ne nuk kërkojmë nga njerëzit kurrfarë shpërblimi, vetëm i lutemi të Dashurit Zot dhe Ate e lusim për ndihmë. Ai do të na ruajë nga mëkatet dhe mosrespektimet”.

Ne “Vëllezërit Muslimanë” jemi pjesë e popullit tonë, ndaj lufta jonë është luftë e tij. Ne sakrifikohemi për realizimin e idealeve tona.

SI TË VIHET DERI TE PASURIA

Vëllezërit tanë të dashur, të cilët merren me problematikën financiare, me brengosje parashtrajnë pyetjen se në ç'mënyrë të sigurohen të hollat për veprimet tona.

Përgjigjja jonë për ta është se në rend të parë duhet që në shpirtin tonë ta zhvillojmë frymën e përpjekjes, ndërsa kërkesa për mjete materiale pason më vonë. Qëndrueshmëria e vendimit, për ngadhënjimin e idealeve tona dhe drejtësinë e bindjeve tona, i paraprin çdo gjëje. Dhe kur njëherë arrihet shkalla e mu'minit, me fuqinë e vërtetë të ndjenjave e të fjalëve, të gjitha kuptimet e ngadhënjimit bëhen reale. “Vëllezërit Muslimanë” kanë kapital të pakët, të mbledhur nga të ardhurat personale të besimtarëve, të cilët i reduktojnë dëshirat e veta dhe dëshirat e të afërmeve për hir të qëllimeve të përgjithshme. “Vëllezërit Muslimanë” pasurinë e tyre rregullisht e harxhojnë në udhë të Allahut xh.sh., e të njëjtën do ta bënin edhe sikur kërkesa për sakrificat të ishte dy apo katër herë më e madhe. Nëse dikush nga “Vëllezërit Muslimanë” nuk ka mjete që do t'i sakrifikoje për Islam, ai ndjehet i brengosur dhe i pafuqishëm.

Rrethana e këtyre mungesës së parave dhe begatia e guximit janë shenjë e mirë për suksesin dhe realizimin e misionit islam.

Allahu i Plotfuqishëm mëshirshëm ka bërë që, një bukë e “Vëllezërve Muslimanë” të jetë më e vlefshme se qindra bukë dhe grumbuj të parave prej ari, të të tjerëve.

“Allahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë besëpreme e mëkatar”. (Kur’ani, 2:276)

“Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shitur e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet te Allahu, e çka të jepni nga sadakaja (bamirësia) me qëllim që t'i afroheni Allahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet shpërblimi.” (Kur’ani, 30:39)

NE DHE POLITIKA

Disa njerëz pohojnë se “Vëllezërit Muslimanë” janë parti politike dhe se lëvizja islame është vepër e rrezikshme politike.

Ne nuk e dimë se kur do të ndalen këto shpifje, sa kohë të gjatë do të jemi viktimë të mosbesimit, kur populli ynë do ta flakë këtë frikë, sa gjatë mund të qëndrojnë shumica e njerëzve në këtë hutim, që i ofendon “Vëllezërit Muslimanë” dhe që u është mërzhitur më.

O njerëz! Ne ju ftojmë në rrugë të së Vërtetës, duke mbajtur në dorën e djathtë Kur’anin, e në dorën e majtë Sunnetin e Pejgamberit tonë s.a.v.s.

Ne ju thërrasim në Islam, në mësimin e tij, në urdhërat e tij dhe në shtigjet e tij. Nëse kjo punë mund të quhet politikë, atëherë kjo është politika jonë. Dhe nëse personi, i cili i fton njerëzit në idetë e tilla themelore të lartësuara është politikan, ne i falënderohemi Allahut për atë lloj të politikës. Nëse dikush lakmon që këtë ta shënojë si politikë, atëherë ai mund të thotë çka të dëshirojë. Kur e drejta do të bëhet e qartë, kur qëllimi nxirret në shesh dhe e vërteta ndriçohet, atëherë çfarëdo emri që do t’i ngjitet lëvizjes islame, nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në ne.

Populli im! Ruani këto fjalë dhe mos e fshihni të Vërtetën, e mos lejoni që dushmanët të tentojnë t’i thyejnë idealet dhe t’ju pengojnë në rrugën e drejtë. Islami, padyshim, u premton ithtarëve të vet lumturinë dhe mirëqenien në të dy botërat. Kjo është natyra e politikës sonë dhe ne nuk do ta ndërrojmë ate me kurrjë tjetër. Nëse i pranoni idealet islame, sukseset tuaja do të jenë të famshme, e ju pret edhe shpërblimi i Zotit në botën tjetër.

“Ky (Kur’ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë për botët. E ju gjithsesi do ta kuptoni pas pak kohe vërtetësinë e tij”. (Kur’ani, 33:87-88)

PËRKATËSIA JONË KOMBËTARE DHE QËNDRIMI I SAJ KRYESOR

Vëllezër të dashur! Ejani dhe së bashku me ne dëgjoni thirrjen madhështore të Allahut xh.sh., e cila jehon në gjithësi e rrymon në tokë dhe në shtatë qiejt. Kjo është thirrje, që në zemrën e çdo mu’mini, zbulon ndjenjën e lartësuar dhe rëndësinë e nderit dhe dinjitetit. Është ky frymëzim shpirtëror, i qenies së pastruar, që përshkon tokën dhe shtatë qiejt, si dhe çdo gjë që gjendet në to. Është kjo thirrja që është e përbashkët për të gjithë vërtetëdashësit dhe e cila vazhdon në të tanishmen dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen për të qenë gjithmonë e dëgjuar.

“Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan...” (Kur’ani, 2:257)

Po vëlla! Kjo për ty është ftesë nga Zoti, i cili është gjithkund i pranishëm. O Zot, Ty Mu’minët të lavdërojnë dhe Të shprehin falënderimin e tyre. Ne nuk mund të Të falënderohemi sa duhet. Ti je mbrojtës dhe mik i mu’minëve, të cilët kanë qenë viktime të dhunës dhe të cilët janë përzënë nga vatrat e tyre. Për ta është nder, sepse gjurmojnë për strehim te Ti, për mbrojtjen Tënde.

“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë e padrejtë, e Allahu ka fuqi për t’u ndihmuar atyre (muslimanëve). (U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: “Allahu është Zoti ynë!” u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte”. (Kur’ani, 22:39-40)

Po vëlla! Eja dhe së bashku me ne dëgjo zërin e Kur’anit të Lartësuar dhe do ta kuptosh mahnitjen, që i përshkon njerëzit

gjatë recitimit të vargjeve të tij. Ne duhet ta rregullojmë librin tonë të jetës, me ndjenjat dhe kënaqësitë e lartësuara që rrjedhin nga mësimi kur'anor. Dëgjo fjalët e Allahut të Plotfuqishëm:

1. “Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirës në dritë...” (Kur’ani, 2:257)
2. “Sepse vetëm Allahu është ndihmëtar juaji dhe Ai është më i miri ndihmës.” (Kur’ani, 3:150)
3. "Mik (i afërt) i juaji është vetëm Allahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zeqatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues).” (Kur’ani, 5:55)
4. “Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga Allahu, Ai është ndihmëtar ynë.” Prandaj, vetëm Allahut le t’i mbështeten besimtarët.” (Kur’ani, 9:51)
5. “(Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepen myzhde në jetën e dynjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim dhe xhennet). Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukcesi i madh” (Kur’ani, 10:63-64)
6. “E atyre që nuk besuan, ata qofshin të përmbysur, Ai atyre ua ka asgjësuar veprat. Këtë për shkak se e urrejtën atë që e zbriti Allahu, prandaj atyre ua zhduk veprat.” (Kur’ani, 47:8, 9)
7. “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (Kur’ani, 49:13)

Për këtë arsye, o vëlla, madhështia e të parëve tanë është se ata i kanë ndenjtur besnikë Allahut dhe, me lutjet e punët e tyre, e kanë ndjekur rrugën e Tij. Njëri nga ata e ka pyetur shokun e

vet: “A është babai yt Jemenî apo Kaisî.” Ai është përgjigjur se i ati nuk është asgjë tjetër por rob i Allahut, që është emri më i ndershëm.

Poeti ka thënë:

“Babai im është Islami, dhe unë nuk kam prind tjetër, e ka njerëz që bëjnë gara dhe grinden se a janë Kaisî apo Temimî.”

Vëllezër të dashur! Njerëzit krenohen me prejardhjen e tyre kur në jetën e të parëve të vet gjejnë madhësitinë dhe dinjitetin. Ata dëshirojnë që ato vlera dhe tipare t’i bartin në bijtë e vet.

Në dashurinë ndaj Allahut gjendet vlera, fisnikëria dhe përsosëria e vërtetë; e për të cilat çdo njeri mund të synojë. Është e vërtetë se Allahut i takon e tërë fuqia, e që Ai mund ta ngejë personalitetin njerëzor deri në shkallët më të larta. Besnikëria ndaj Allahut e ngre shpirtin njerëzor mbi masën e njerëzve dhe ia hapë dyert e suksesit. Shpërblimi më i madh për njeriun është besnikëria ndaj Allahut.

Për këtë Allahu thotë:

“S’është e drejtë as nuk i takon asnjë njeriu që t’i ketë dhënë Allahu librin, urtësinë dhe pejgam-berllëkun, e pastaj ai t’u thotë njerëzve: “Bëhuni rob të mi (adhuromëni mua) e jo të Allahut!” por (ju thotë): “Bëhuni dijetarë të mësimëve të Zotit, ngase u keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë.” (Kur’ani, 3:79)

BURIMI MË I RËNDËSISHËM I FUQISË

Besnikëria ndaj Allahut duhet të jetë e thellë dhe e vërtetë, e tek atëherë njeriu shkon kah rëndësia e vet e lartë. Kjo siguron bekimin e Imanit dhe lojalitetin ndaj Islamit, që i ndriçon njerëzit me dritë të vërtetë. Njeri, kur ta realizosh këtë shkallë, ti

nuk do të frikësohesh nga asgjë në këtë botë, pos nga Allahu, e as që do të mund të të thyejë dikush; qoftë edhe nëse tërë bota ngrihet kundër teje e të mundohet ta trondisë luftën tënde dhe qëndrimin tënd.

Këta besimtarë të vërtetë i pret shpërblim i madh tek Allahu.

“E atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: “Populli (idhujtarët) është tubuar t’ju sulmojë, pra kini frikë!” Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: “Neve na mjafton që kemi Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë!” (Kur’ani, 3:173)

Prandaj besimtari, që merr pjesë në luftën për Islam, edhe pse ndaj tij aplikohen frika, terrori dhe persekutimet, nuk do të frikësohet dhe nuk do t’i shmanget luftës, sepse ai frikësohet vetëm nga Allahu. A mund të ketë dikush forcë më të madhe se besimtari, zemra e të cilit digjet me flakën e fesë dhe shpirti i të cilit shkëlqen me admirimin për Islam?

PËRKATËSIA JONË NË IDENË E ISLAMIT KA KARAKTER TË GJERË

Njëra nga përparësitë e mëdha që i bashkon muslimanët është ideja e Islamit. Kjo frymë ideore e unitetit i shemb të gjitha pengesat, që i krijojnë nacionalizmi, separatizmi dhe kundërshtitë fisnore. Cili faktor, përndryshe, do të mundej që aq qëndrueshëm ta farkojë vëllazërinë midis njerëzve, përveç Islamit-besimit në Një Zot.

ËNDRRAT E DJESHME JANË ÇELËS I TË SOTMES

Njerëzit e kanë pranuar shkencën e Islamit, por jo gjithmonë në mënyrë të drejtë dhe efikase, kështu që idetë e Islamit në zemrat e njerëzve, kanë humbur forcën e tyre, ndaj janë bërë mit dhe mister. Disa njerëz kanë shprehur habi si u krijua vëllazëria midis muslimanëve. Ata u janë drejtuar gjërave më pak të rëndësishme, duke shfaqur dyshim në mundësinë e realizimit të idealeve islame.

Vëllezër në Islam! Kjo që ju tani e konsideroni të pakuptimtë dhe të paqartë, kjo ka qenë e vërtetë dhe realitet. Edhe përpjekjet tona nuk do të japin fryt, përderisa mos ta njihni të vërtetën.

Muslimanët e kohës së parë islame e kanë kuptuar qartë domethënien e Kur'anit dhe ndjenjën e kënaqësisë së fesë - kjo është ajo të cilën muslimanët e sotëm duhet ta përvetësojnë.

Është ky besimi i “Vëllezërve Muslimanë” se ajo ekziston në fuqinë e Kur'anit Famëlartë. Prej aty pritet shpëtimi si dhe sakrificimi i jetës së tyre për Islam. Ithtarët e Thirrjes islame, “Vëllezërit Muslimanë”, gjejnë bukurinë e jetës në kuptimin e të jetuarit në këtë drejtim.

“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetë që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës”. (Kur'ani, 57:16)

Vëllezër të nderuar! Kur do të vini (bashkoheni) pranë nesh, pranë idesë islame, besimi juaj në Allahun e Plotfuqishëm ju obligon në përmbushjen e borxhit ndaj vetvetes; përgjegjësia e

punës dhe sakrificat bien mbi shpatullat tuaja, e e tërë kjo në udhë të Zotit. A jeni të aftë dhe të përgatitur për këtë?

MISIONI I MUSLIMANËVE

Misioni i muslimanëve qëndron në atë që ta përhapin dhe ta përçojnë dritën dhe të vërtetën islame, të shpallur nga Allahu i Plotfuqishëm, në Librin e Tij Famëlartë. Këtë detyrë të muslimanëve, Kur’ani e thekson dhe e rithekson. Me këto ajete, muslimanëve u udhëzohet porosia për jetë:

“O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurone. Bëni punë të mira (të dobishme), se do të gjëni shpëtim. Luftoni me një luftë të denjë për hir të Allahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur’an) ju quajti muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me Allahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është.” (Kur’ani, 22:77-78)

Kjo, në gjuhën arabe, është thirrje e qartë dhe në të nuk ka dykuptimshmëri, s’ka dyshim e as fjalë të pakuptueshme. Të qenët në rrugën e Zotit është kënaqësi e madhe personale, e rrezatuar me dritën e shkëlqyer dhe vezulluese të agimit. Ajo është vrull që ndriçon qiejt, pa kurrfarë dëshirash dhe pasionesh dhe depërton në zemrat tona. E tani a nuk e dëgjojnë muslimanët këtë thirrje? Apo e dëgjojnë, por në zemrat e tyre kanë drynat dhe nuk mund ta kuptojnë tërë rëndësinë e thirrjes.

Allahu i urdhëron muslimanët që t’i luten Atij e t’i bëjnë sexhde-namazi është esenca, thelbi i ibadetit. Ai është shtylla e Islamit

dhe zë pozitën më të rëndësishme në të shprehurit e bindjes islame. Allahu u urdhëron muslimanëve që të ruhen nga veset dhe që plotësisht t'i dorëzohen vetëm Atij në ibadet, duke bërë vepra të mira. Urdhëri i Allahut për kryerjen e veprave të mira në të njëjtën kohë don të thotë edhe ndalim nga të këqijat.

E para midis veprave të mira është respektimi i dinjitetit njerëzor. Sa koncize dhe e plotëkuptimtë është kjo thirrje! Nga ajo varet sukcesi ynë, mirëqenia dhe lavdia. Misionit të kësaj thirrjeje, për hir të vetvetes dhe për hir të qëllimit të përbashkët, duhet t'i përgjigjet çdo musliman.

E DREJTA E HUMANITETIT (NJERËZISË)

Pas kësaj, Allahu i Plotfuqishëm u urdhëron muslimanëve që për Te të nisen në Xhihad, duke u përkushtuar plotësisht në luftën për Islam, ashtuqë thirrja e Allahut të arrijë gjithkund dhe t'i përqafojë të gjithë njerëzit me forcën e arsyeshmërisë së vet dhe me vërtetësinë e argumenteve të saja. Por nëse disa njerëz nuk pranojnë ta dëgjojnë këtë thirrje, por e pengojnë përhapjen e saj, i kundërvihen dhe e refuzojnë, atëherë si masë e fundit vjen shpata e muxhahidit, e cila do t'ia çelë dyert lirisë së thirrjes.

Poeti ka thënë:

“Nëse njerëzit refuzojnë ta dëgjojnë të Vërtetën, dhe pengojnë përhapjen e saj...

Atëherë më mirë është luftë se paqe në botë...”

MBROJTJA E SË VËRTETËS ME FORCË

Sa me mend është thënë: “Për vendosjen e së vërtetës në botë, ithtarët e së Vërtetës duhet të kenë forcën. E Vërteta dhe forca do të japin rezultate.”

Prandaj Xhiahadi është njëra nga detyrat themelore të muslimanëve. Xhiahadi paprekshëm i mbron farzet islame dhe i obligon muslimanët për kryerjen e detyrave islame. Xhiahadi është obligim për çdo mu'min. Askush nuk duhet të jetë i liruar nga ky obligim - secili do t'i përgjigjet atij sipas aftësive të veta.

“Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni.” (Kur’ani, 9:41)

Ndihma e Allahut e përkrah këtë udhë dhe punë të mundimshme, e Allahu i Plotfuqishëm i urdhëron muslimanët që të bëhen prijës të krijesave të Tijja, interpretues të shariatit të Tij, ushtarë në shërbim të Allahut, trashëgues të të Dërguarit të Zotit, Muhammedit s.a.v.s., në thirrjen dhe luftën për Islam. Allahu për njerëzit e ka shpallur Dinin e Vet, të përbërë nga një varg urdhëresash e ndalesash të shariatit. Ai ato i bëri fleksibile dhe të pranueshme për tërë botën.

Rregullat e Allahut xh.sh. i ofrojnë gjinisë njerëzore që të zhvillohet në të gjithë lëmenjtë, e pikërisht ato paraqesin shpresa dhe synime për të cilat njerëzimi është i flaktë.

“Luftoni me një luftë të denjë për hir të Allahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur’an) ju quajti muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me Allahun se ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës

i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është.” (Kur’ani, 22:78)

Ky është mision serioz i të gjithë mu’minëve, në të cilin Allahu i ka ftuar besimtarët, përmes të cilit i vë në një radhë të qëndrueshme luftarake, në një forcë, në një fuqi. Kështu muslimanët bëhen ushtri, e cila i braktisë dëshirat vetjake dhe me tërë qenien i përkushtohet kësaj ftese të ndershme, për ta udhëzuar gjininë njerëzore në udhën e së Vërtetës. Ata muslimanë, të cilët i përgjigjen ftesës së Allahut, natën luten e ditën janë kalorës dhe luftëtarë për çështjen islame.

Allahu e ka ndriçuar marrëdhënien midis ibadetit individual (namazit, agjërimit) dhe ibadetit kolektiv (punës dhe luftës për Islam). Këto ibadete, për besimtarët e vërtetë, janë të ndërlydhura dhe njëri ibadet nuk mundet pa tjetrin. Nuk ka arsytim për ata të cilët e kryejnë vetëm ibadetin individual dhe nuk ka arsytim për ata që e kryejnë vetëm ibadetin kolektiv. Allahu xh.sh. thotë:

“...E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie?”
(Kur’ani, 4:87)

O muslimanë, nisuni në Xhihad në udhë të Zotit, i cili ju ndihmon, vendosni Dinin e Tij dhe Sheriatin e Tij. Vetëm kjo është detyrë e jetës suaj në Tokë. Nëse e plotësoni krejtësisht këtë mision, ia keni arritur qëllimit, por nëse devijoni në ndonjë aspekt, ose u drejtoheni gjërave të padobishme, atëherë keni ardhur në kundërshtim me fjalët e Allahut xh.sh.:

“A menduat se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do të ktheheni te Ne?” (Kur’ani, 23:115)

Për këtë arsye të rëndësishme, as'habët e Pejgamberit a.s. kanë qenë krijesat më të zgjedhura, më të përkushtuarit midis të përkushtuarve dhe për ata është thënë: “I kushtoheshin namazit natën, ndërsa luftës ditën.”

Nëse e kërkoje dikend nga ata natën, e shihje se si përkulet me përkushtim në xhami dhe si bie në sexhde.

E kur agonte dita, dhe thirrja për Muxhahidët përhapej nëpër ajër, ai ishte në kalë në vrapim, thirrte klithmat luftarake dhe merrte pjesë në të gjitha vendet e fushëbetejës.

Për Allahun! Sa bukur janë të ndërlidhura dy cilësitë e ngritjes shpirtërore dhe luftës në këtë botë në rrugë të Allahut xh.sh. Islami është feja që i përmban të gjitha mirësitë.

UDHËHEQJA KRIJUESE DHE E REFORMUAR

Kur Pejgamberi i shquar e braktisi këtë botë, muslimanët u shpërndanë në të gjitha anët e botës për ta përhapur thirrjen e tij. Thellë në zemrat e tyre, e mbanin me vete Kur'anin. Banonin në shalët e kuajve të vet. Mbanin shpatat në dorë. Predikimi i tyre, me fjalë të qarta, përqëndrohej në atë se i ftonin njerëzit në njëren nga tri gjërat; kalimin në Islam, pagesën e xhizjes ose luftën. Ata, të cilët e pranonin Islam, bëheshin vëllezër të tyre. Ata të cilët përcaktoheshin për pagesën e xhizjes, fitonin mbrojtjen e luftëtarëve islamë. Të drejtat e tyre ishin plotësisht të mbrojtura në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre dhe muslimanëve. E ata të cilët e refuzuan thirrjen dhe e pranuan luftën, ata edhe e gjetën atë luftë, në të cilën Allahu xh.sh. ua garanton epërsinë besimtarëve.

“Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën e Allahut, e Allahu nuk do tjetër, pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë.” (Kur’ani, 9:32)

Xhiahadi nuk përbëhej vetëm nga çlirimi i vendeve. Qëllimi ishte mbi famën dhe shkëlqimin e suksesit. Muxhahidët, në vete, me luftë e pastronin bindjen e tyre. E përforconin atë. Halifi i tyre

zgjidhej nga mesi tyre. Pjesa e tij në pronë dhe në fitim, nuk ishte hiç më e madhe nga ajo e luftëtarëve tjerë. Halifi nuk kishte kurrfarë pozite të veçantë, e as që ishte më i sigurt nga të tjerët. Përveç se me shquarjen e tij në luftë dhe vendosmërinë e besimit, me çka e kishte shpërblyer Allahu xh.sh., ai me asgjë tjetër nuk dallohej nga muslimanët tjerë. Ata halifë nuk lakmonin pasurinë dhe bollëkun. Një copë buke mjaftonte ta zbusë urinë e tyre, një gllënkë ujë e shuante etjen e tyre. Për ta agjërimi e kishte domethënien e përfitimit të afrisë Hyjnore. Uria u ishte më e dashur se barku i plotë. Veshja e tyre ishte aq e thjeshtë e skamnore, sa që e mbulonte vetëm pjesën e trupit që ishte e domosdoshme sipas rregullave. Urdhëresat Kur'anore i respektonin me përpikëri.

“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu do t'i shtie në xhennete nëpër të cilët rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri.” (Kur'ani, 47:12)

Në mend gjithnjë i kishin fjalët e Resulullahut a.s.:

“Të mallkuar janë robërit e parave, robërit e veshjes, robërit e materies.”

Nuk lakmonin pozitat e privileguara, famën, pasurinë, bollëkun, pushtetin, shtypjen, dhunën. Qëllimi i tyre ishte i pastër e i çiltër si burimi. E transmetonin porosinë, të cilën ua kishte dorëzuar Pejgamberi i Allahut xh.sh., si kusht dhe detyrë. Ai u urdhëroi që të marrin pjesë në Xhihad, në mënyrë që porosia të përhapet në të gjithë popujt.

PËR NE ËSHTË KOHA QË TË KUPTOJMË

Muslimanët e periudhës së hershme islame e kuptonin porosinë, punonin në përhapjen e saj dhe sakrifikoheshin në atë rrugë. Por, sot midis muslimanëve ekziston hamendje. Muslimanët kanë mendime divergjente lidhur me misionin. Për ta arsyetuar mosangazhimin e tyre, ata thirren në të gjitha pretekstet e mundshme.

Disa nga ata thonë se koha e Xhihadit ka kaluar, derisa të tjerët mbjellin dëshpërim dhe hutë midis muslimanëve, duke u thënë se nuk ka mjete materiale. Ndërsa të tretët mendojnë se mjafton vetëm të kryhet lutja në mëngjes e në mbrëmje, duke folur për Islamin vetëm si aktualitet, por pa kurrfarë pune dhe sakrificash,

Jo, vëllezër islamë! Kur’ani qartë na ka thirrë, që ta kemi vëmendjen në fjalët më të pastërta;

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetit.” (Kur’ani, 49:15)

Në një hadith është thënë se, kur njerëzit do të bëhen dorështrenguar në pikëpamje të parave, kur të fillojnë të punojnë me kamata, kur të ikin e ta braktisin Xhihadin; atëherë Allahu mbi ta do t’i lëshojë pamëshirën dhe poshtërsinë, dhe do të jenë në pamëshirën e Allahut deri atëherë deri sa prapë mos t’i kthehen, sinqerisht, fesë së vet.

Ky hadith është transmetuar përmes Abdull-llah bin Umerit, nga imam Ahmedit në *“Musnedin”* e tij, mandej në *“El-Kelimin”* e Tibraniut dhe përmes Bejhekit në *“Shu’b-ul-Iman”*.

Me siguri keni lexuar, në librat e Fikhut, se në një kohë Xhihadi bëhet Farzi Kifaje, e në një kohë tjetër Farzi Ajn. Ju keni mësuar

ç'është Xhiahadi dhe sa i rëndësishëm është ai. E përse pra ju kaplon dëshpërimi dhe dobësia i pushton zemrat tuaja?

O muslimanë-muxhahidë! Kjo është kohë e aksionit! Përgatituni për ta transformuar popullin islam dhe në të ta derdhni aktivitetin jetësor! Kjo detyrë i kërkon mu'minët, të cilët posedojnë zemër të vërtetë besimtari. Shfrytëzoni besimin e zemrës suaj dhe forcën tuaj, në udhën që kërkon sakrificat tuaja në të mirat materiale dhe viktima në jetërat tuaja. Tregoni gatishmëri të plotë në këtë udhë, sepse kjo jetë është e shkurtër, e vetëm Allahu xh.sh. është i amshuar dhe i përhershëm. Allahu xh.sh. i ka marrë jetërat e besimtarëve si këmbim për parajsën, e cila i rrethon qiejt e tokën, e me të cilën Ai do t'i shpërblejë.

PREJ NGA DO TË FILLOJMË

Kjo detyrë e rilindjes së popullit musliman, zgjimit të tij, ngritjes në shkallë më të larta, kërkon nga realizuesit e saj, të cilët i janë përgjigjur thirrjes së Allahut xh.sh., fuqi të madhe të bindjes në cilësitë vijuese:

- në vendosmërinë; që nuk do t'i japë fuqi dobësisë dhe hamendjes,
- në ekzistimin e besnikërisë; që nuk do të gjunjëzohet para viktimit të mosbesimit dhe tradhtisë,
- në sakrificën e dobishme; që do të jetë e liruar nga lakmia dhe koprracia e kësaj bote,
- në të besuarit themelor, të bazuar në luftën e vazhdueshme; ashtuqë personaliteti të jetë i shpëtuar nga devijimi dhe pavendosmëria në rrugën e drejtë; nga të gjitha sulmet dhe rrezikimet nga ana e cilitdo qoftë.

Këto janë parimet themelore që tërheqin fuqishëm. Ato japin

fuqinë shpirtërore, e cila e formon thelbin e besimit themelor. Ato e kultivojnë revolucionin në shoqëri dhe e ndërtojnë jetën e gjeneratës së re. Me këto parime arrihet deri te ngjallja e sërishme e vlerave dhe kuptimeve, nga të cilat, për një kohë të gjatë, kemi qenë të privuar.

Nëse ndonjë grup i braktis këto parime, ose e humb besimin në vërtetësinë dhe mëkëmbjen e parimeve të Thirrjes, duhet ditur se ky grup është i pavlefshëm dhe i denjë për përbuzje, ndaj nuk është në gjendje që t'i realizojë idealet tona. Ai do të kërkojë jetë midis miteve dhe besëtytnive, në ishullin e vet të ëndrrave; ndërsa idetë e atij grupi, fantastike përkrah esenca, nuk mund të ndihmojnë në realizimin e së Vërtetës. Ky është ligj dhe traditë e Allahut të Plotfuqishëm, nuk ka dhe nuk mund të ketë, e as që ka pasur ndryshime në metodat e Tij.

“Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.” (Kur’ani, 13:11)

Ligjet e Allahut xh.sh. i kemi pranuar përmes Pejgamberit tonë s.a.v.s., e ja një porosi e Pejgamberit për muslimanët:

“Njëherë një popull tjetër do t’ju nënshtrojë dhe do të vërsulet mbi ju ashtu siç hidhen njerëzit e uritur mbi pjatën me ushqim. Dhe Allahu i Plotfuqishëm do të mbjellë frikën në zemrat tuaja nga zemrat e dushmanëve tuaj, si “Wehn”.

Njëri nga as'habët e pyeti Pejgamberin a.s.: “O i ndershmi, a do të jemi në numër të vogël atëherë, në atë kohë?” Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Jo, ju në të vërtetë do të jeni shumë në numër, por do të jeni si fija e kashtës ndaj rrebeshit (vërshimit)”. As'habi tjetër pyeti: O i Dërguari i Zotit, ç’është Wehni?” Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Dashuria për këtë botë dhe frika nga vdekja.”

Edhe me këtë porosi, Pejgamberi a.s. e përshkroi qartë rastin e shkatërrimit të një populli, si dashuri të thellë për këtë botë dhe

kënaqësitë, e si neveri dhe frikë para vdekjes; si dobësi të zemrës, mungesë të ligjeve të larta morale dhe mungesë të virtyteve të vërteta njerëzore. Numri i madh i popullit nuk ka kurrfarë rëndësie. Shmangia nga e Vërteta është nder i shkelur i popullit, kështu që shpresat dhe synimet bien në pluhur. Kjo ngjan për shkak se këta njerëz janë mësuar me jetë të rehatshme, janë ngatërruar në materializëm, janë zhytur në pasionet e jetës së kësaj bote; duke i dhënë përparësi veshjes, stolisjes dhe kënaqësive, para së Vërtetës dhe detyrave, të cilat ajo i cakton.

NDËRMJET DY FUQIVE

Shumë njerëz mendojnë se popujt islamë nuk mund të krijojnë progres pa fuqi materiale, pa bollëk mallrash, pa fuqi ushtarake, e as që mund të krahasohen me ata popuj, të cilët i kanë uzurpuar të drejtat e tyre dhe të cilët i shtypin ata. Ky është një konstatim i saktë dhe tejet i rëndësishëm. Mirëpo gjëja më e rëndësishme dhe më qenësore nga këto, është fuqia shpirtërore, e cila i vë në lëvizje cilësitë e moralit të lartë, gjykimit të mprehtë, të menduarit të pastër, besnikërisë ndaj parimeve, njohjes së detyrave, përcaktimit të fortë, ndjenjës së sakrificës, qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe synimit drejt bashkimit të popujve. Është fakt se këto dy të vërteta të fuqive materiale dhe shpirtërore, të bashkuara ofrojnë mundësi kolosale që shpiejnë drejt fuqisë së vërtetë.

Nëse popujt muslimanë fillojnë t'i kthehen Islamit të vërtetë, do të vijnë deri te ndryshimet e pashmangshme, do të shtohen synimet për arritjen e fuqisë shpirtërore dhe zhvillimin e virtyteve morale; e me vetë këtë do të bëhet edhe ngritja materiale. Historia dëshmon vërtetësinë e këtij pohimi.

“Vëllezërit Muslimanë” luftojnë për realizimin e të gjithë këtyre qëllimeve, e këtë e bëjnë për shkak se dëshirojnë t’i pastrojnë shpirtërat e vet, t’i këndellin mendimet e ta ngrisin moralin. Ata mundohen që t’i përfitojnë këto virtyte përmes bashkimit të ndërsjellë. Ata përpiqen që t’i njoftojnë njerëzit me të vërtetat fundamentale islame. Ata nga populli kërkojnë vetëm pastërtinë e të gjykuarit dhe lartësinë e parimeve morale. “Vëllezërit Muslimanë” nuk rekomandojnë diçka që do të vinte ndesh me udhën e drejtë. Ata flasin atë që e flasin të gjithë. Por, ata kërkojnë ndjekjen pa kompromise të burimit të lartësuar - Librit të Allahut xh.sh.. Ata njohin të vërtetën e ligjit të pandryshueshëm.

“...Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...” (Kur’ani, 13:11)

Këtë pohim Kur’ani Famëlartë e zbulon në shumë ajete tjera. Ky është fakti që për ne është shembull, e i cili do ta ndërrojë gjendjen tonë. Kjo është më e qartë se çdo gjë e qartë dhe më e vërtetë se çdo pohim i vërtetë. Ky është tregimi për bijtë e Izrailit (Benu Israil) i përmbajtur në këto fjali-i cili siguron renesansën për çdo popull të përlur.

UDHA E QARTË

“Vëllezërit Muslimanë” besojnë se Allahu xh.sh. e ka dërguar Kur’anin Famëlartë dhe u ka urdhëruar robërve të Vet që ta pasojnë Pajgamberin s.a.v.s. dhe e ka shfaqur kënaqësinë e Vet me ithtarët e tillë, të dëgjueshëm ndaj Dini Islamit. Allahu në këtë Din të qartë dhe të kuptueshëm i ka sqaruar të gjitha parimet e nevojshme për jetën, përparimin dhe të mirën e një populli. Fjalët vijuese të Allahut xh.sh., e vërtetojnë këtë

mendim: “...e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që argumentet Tona i besojnë. Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuar.” (Kur’ani, 7:156-157)

Muhammedi a.s. ka thënë: “Për Zotin, nuk ka mbetur asnjë vepër e ligë, e që për të nuk ua kam tërhequr vërejtjen.”

Nëse futeni thellë në mësimin islam, do të gjeni rregulla të formuluar në mënyrë jashtëzakonisht korrekte, një sistem shumë tërheqës të kornizuar në ligje tejet të qëndrueshme dhe autentike. Ky sistem i rregullave jetësore është shumë i volitshëm për burrat dhe gratë, është i përshtatshëm për jetën familjare dhe përmes tij zgjidhen të gjitha problemet. Këto ligje ndihmojnë në zhvillimin e jetës kolektive dhe në analizat e rasteve të ngritjeve dhe rënieve. Ata sigurojnë zgjidhjen e problemeve, me të cilat ballafaqohen reformatorët dhe prijësit e popujve dhe të bashkësive.

Ne besojmë se Islami siguron zgjidhje të drejta e të shëndosha për të gjitha problemet. Këto zgjidhje mund të aplikohen në mbarë botën e sotme, në çdo komb në veçanti: në komunizëm, në kapitalizëm, në teoritë bolshevike, në luftë, në blloqet ushtarake të shteteve, në vrasësit dhe të vrarët, në ndihmën farefisit etj. Këto janë probleme që e preokupojnë vëmendjen e ekspertëve dhe të politikanëve të rëndësishëm të filozofisë së kolektivizmit. Islami ofron sistem të tillë universaliteti, saqë

edhe përkundër ndikimeve personale dhe subjektivizmit, ai mund t'i plotësojë, në mënyrë adekuate, kërkesat e mbarë botës. Ky nuk është momenti për të hyrë në detaje, por ne ofrojmë shikimet dhe kuptimet tona të qarta në mënyrë të kristaltë, duke ua shpjeguar njerëzve problemet dhe rastet, që ato për ta të bëhen sa më të kuptueshme.

KURSI YNË ËSHTË DËGJUESHMËRIA

Ky është besimi i “Vëllezërve Muslimanë” dhe ne i ftojmë njerëzit që ta pranojnë shkencën e Islamit. Parimet islame paraqesin bazën e progresit për të gjitha lëmenjtë e jetës së Lindjes, e cila shërohet nga sëmundja. “Vëllezërit Muslimanë” besojnë se të gjitha idetë dhe metodat e sotme të përhapura, janë të kundërta me Islamin. Ato janë në konflikt me dispozitat kur’anore. Pranimi i metodave joislame do të sillte deri te dështimet dhe përvojat e dhimbshme, e Ummeti nuk do ta gjente më udhën e drejtë, as me sakrificat të mëdha.

Prandaj u rekomandohet popujve që synojnë të hapërojnë rrugëve të progresit, që gradualisht dhe qetë, duke i ndjekur ligjet e Islamit, të shkojnë drejt suksesit.

Ky mision, kjo thirrje e “Vëllezërve Muslimanë” nuk është e kufizuar vetëm në një territor, vetëm në një shtet ose vetëm në Botën islame.

“Vëllezërit Muslimanë” e ngrejnë zërin e vet, me shpresë se thirrjet e tyre do të arrijnë deri te prijësit dhe kryetarët në territoret ku banojnë muslimanët.

“Vëllezërit Muslimanë” dëshirojnë që thirrja e tyre të depërtojë gjithkund. Dhe, kur bota muslimane të niset kah bashkimi i vet dhe kah themelimi i ardhmërisë së vet, ky zë i së vërtetës duhet

të arrijë deri te veshët e muslimanëve. Tani bota muslimane nuk do të guxonte të niset, me hap të gabueshëm, kah bashkimi i saj; me hapin i cili është në kundërshtim me parimet islame. Nëse e bëjnë muslimanët këtë, atëherë mund të ndodhë që popujt islamë në vend që të nisen lartë kah majat, të pësojnë degradacion (rënie).

FRIKA NGA DEVIJIMI

Rreziku më i madh nga i cili frikësohen “Vëllezërit Muslimanë” është ndjenja e inferioritetit të popujve dhe nënshtrimi i tyre klasëve sunduese, poltronizmi i tyre ndaj ideve të huaja joislame, si dhe orvatjet që ato ide të përpunohen për popujt islamë. Prandaj muslimanët duhet të përpiqen që në kushtetutat e shteteve islame të hyjnë parimet kur’anore dhe që Kur’ani të jetë themel për tërë rregullimin shoqëror. Neni i parë i kushtetutës duhet të jetë: “Feja zyrtare është Islami”, dhe të gjitha nenet tjera të kushtetutës të jenë në përputhje me Islamin. Në kushtetutë mund të jetë vetëm ajo që nuk është në kundërshtim me Islamin.

REFORMA E LIGJIT

Çdo komb, ose grup njerëzish, ka ligje sipas urdhërave të të cilëve udhëhiqen njerëzit. Për ne, ligjet e tilla dalin nga mësimi kur’anor. Parimet e legjislacionit të tillë duhet të jenë në përputhje me parimet kur’anore dhe me shkencën juridike islame. Sheriati dhe parimet juridike të Islamit, të zbatuara nga ana e juristëve islamë, janë të atilla që me to zhduken veset, ndërsa kënaqen të drejtat e njerëzve. Me vetë këtë janë arritur rezultate të mëdha. Po që se ndalesat, e caktuara nga Allahu xh.sh., aplikohen në mënyrë të përpiktë, kriminaliteti do të ndalohej. Nëse kriminaliteti ndalohet e kriminelët dënohen në

mënyrë të drejtë, dhuna dhe provokimet do të çrrënjosen. Rregullimi mbi parimet e tilla shpie vetëm drejt shpëtimit dhe paqes. Përvoja nga historia e mbështet këtë pohim dhe me të vërtetë drejtësia e legjislacionit të këtillë është vërtetuar. Në krahasim me këtë, ligjet e sotme janë të atilla që e nxisin kriminalitetin dhe bëhen burim i përhapjes së tij. Allahu i Plotfuqishëm, ka vënë mbi ne obligim absolut, se legjislacioni musliman duhet të jetë në përputhje me Kur'anin.

“... E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues”. (Kur’ani, 5:44)

REFORMA E DEMONSTRATAVE MASIVE

Çdo popull, në manifestimin e jetës së tij, ka rrugën e vet. Qeveritë e atyre popujve janë të njohura mirë me këtë dhe, me qëllim të ekspozimit të fuqisë së vet, i rregullojnë ligjet e veta.

Popujt muslimanë duhet ta harmonizojnë mënyrën e vet të jetës me parimet e Kur’anit dhe të sheriatit. Ekzistimi i “bordelit” është njollë e turpshme në shpirtin e një populli,

Dhe ç’ka ngjarë - derisa populli islam luftonte kundër kurorëshkeljes dhe derisa kryente obligimet e veta ndaj fesë, në të njëjtën kohë ky mëkat komercial rritej në gjirin e muslimanëve.

“... dhe me zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që besoni Allahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh.” (Kur’ani, 24:2)

Shitësit e alkoolit hasen nëpër rrugët e qyteteve tona. Alkooli lirisht propagandohet. Sasi të mëdha të pllakatave provokuese

me lavdërimin e verës dhe reklama të paturpshme të “nënës së veseve” shpërndahen. E gjithë kjo është e ndaluar me Islamin dhe ky haram rreptësisht është sulmuar në Kur’anin Famëlartë.

LUFTA KUNDËR ANARKISË

Anarkia e këtillë njihet vepra të këqija dhe të padobishme, zbatimje të pakuptimta, marrë të pranishme gjithkund; por të gjitha këto janë plotësisht në kundërshtim me Islamin, i cili urdhëron ithtarët e vet që të shkojnë shtigjeve të guximit jetësor, që të ruhen nga përtacia dhe sipërfaqësorja, t’i largohen shoqërimit me njerëz të padobishëm dhe të këqij. Allahu xh.sh., e don shoqërimin e ndërsjellë të muslimanëve, ndërsa i urren veprat e liga.

Është me rëndësi për muslimanët që ta arrijnë përsosmërinë e tyre dhe t’i pengojnë veprat e liga me forcë, me aparat shtetëror ose me ligjet ekzistuese. Ata asesi nuk guxojnë të ndalen në këto përpjekje të tyre.

EDUKIMI I ORGANIZUAR

Detyrë e obligueshme e çdo grupi muslimanësh është që t’i kushtojnë kujdes të plotë edukimit të gjeneratave të reja, që ato të jenë në gjendje ta bartin flamurin e thirrjes islame në ardhmëri. Prandaj është më se e nevojshme që të vendoset një sistem i edukimit islam mbi parime të parapara, i cili do t’i rrënjosë, në shpirtërat e të rinjve, mendimet dhe direktivat islame, duke e ruajtur gjatë kësaj shëndetin e jetën e tyre; duke i mësuar për rregullat fetare; duke e zhvilluar në ta vetërespektimin dhe duke i zgjeruar kuptimet e tyre mbi idetë bashkëkohore. Këto janë esencat e punës, në të cilat bazohet

mësimi mu'minor.

“Vëllezërit Muslimanë” mundohen që populli islam ta pranojë të kuptuarit islam dhe që mu'minët të jenë mburojë në momentin kur do të fillohet të ndiqen udhët e progresit modern. “Vëllezërit Muslimanë” ua tërheqin vëmendjen të gjithë muslimanëve në këtë thirrje.

Mënyra, që të kuptohet dhe të pranohet thelbi i parimeve islame, është njoftimi i gjerë për shkencën e tij, ndalesat dhe urdhëresat; ashtu që njerëzit prapë ta pranojnë Islamin dhe të jenë të bindur në të mirat e tija të mëdha, në të vërtetën dhe në përparësitë. Kjo është në frymën e fjalëve kur'anore:

“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu e unë nuk jam nga idhujtarët”. (Kur'ani, 12:108)

PËRPARËSITË E MARRËDHËNIEVE VËLLAZËRORE

Islami i fton ithtarët e vet me Thirrjen kur'anore:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e Allahut, e mos u përçani! Përkujtonie nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur”. (Kur'ani, 3:103)

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër.” (Kur'ani, 49:10)

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin...”

(Kur'ani, 9:71) Muhammedi a.s. ka thënë: “Robërit e Allahut janë vëllezër”.

Muslimanët e periudhës së hershme e kishin kuptuar thellë domethënien dhe kuptimin e këtyre ajeteve dhe haditheve. Me Islamin është proklamuar vëllazëria e vërtetë dhe ata, në këtë udhë, kanë pasur besim të patundshëm.

Dashuria e vërtetë midis njerëzve dhe vëllazëria e vërtetë gjenden vetëm në fenë e Allahut. Muslimanët, përmes idesë së vet, janë aq të afërt saqë bëhen si një shpirt, si një zemër, si një dorë. Kjo e vërtetë rrjedh nga Libri i Allahut, si mëshirë për njerëzit.

“Po nëse duan të mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton Allahu. Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e vet dhe me besimtarët. Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë.” (Kur'ani, 8:62-63)

PAJTUESHMËRIA

Ata muhaxhirë, të cilët i braktisën familjet e veta, u ndanë nga vendlindja e vet dhe u shpërngulën në Medine, me qëllim të ruajtjes së Dinit; hasën në popullin e Medines, i cili tanimë e kishte pranuar Islamin. Ensaritë përzemërsisht i pranuan muhaxhirët nga Meka, i furnizuan, filluan t'i duan dhe ndjenin kënaqësi në ardhjen e tyre; edhe pse nuk pritnin kurrfarë kompensimi material dhe nuk ishin në kurrfarë marrëdhënie farefisnore me ta. Kjo ishte një ndjenjë e thjeshtë islame, e cila i bëri ensaritë zemërgjerë, i lidhi ata me muhaxhirët, duke i transformuar në një shpirt, në një ide. Çdo ensari i ofroi të mirat

e veta materiale për muhaxhirët, u jipte përparësi atyre e jo vetes, u bë mbrojtës i tyre dhe ishte i gatshëm që të japë jetën e vet dhe të familjes së vet për mbrojtjen e muhaxhirëve. Ensaritë aq shumë dëshironin dhe tentonin t'u ndihmojnë muhaxhirëve, sa që ndih- ma e tyre ndahej me short.

Imam Buhariu e ka vërtetuar këtë me hadithin vijues:

“Çdo muhaxhir është vendosur me short te vëllai ensari”.

Kur'ani Famëlartë e ka përjetësuar kujdesin e madh të ensarive. Kjo do të shërbejë si shembull, deri në fund të botës dhe gjithmonë do të na ndriçojë.

Allahu xh.sh., thotë:

“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.” (Kur'ani, 59:9)

Bijtë e Islamit u nisën këtij shtegu të virtyteve. Në zemrat e tyre u mboll vëllazëria luftarake. Nuk kishte kurrfarë dallimi mes muhaxhirëve dhe ensarive, e as që kishte ndonjë ndarje midis popullit të Mekes dhe atij të Medines; kështu që Muhammedi a.s. i lavdëroi ensaritë me këto fjalë:

“Ensaritë janë njëra nga bashkësitë më të bukura. Kur i vendosnin grupet e muhaxhirëve, grumbullonin ushqim aq sa mundeshin dhe të gjithëve, edhe vetes edhe atyre, u ndanin në pjesë të barabarta!”

E kur e studion Kur'anin, Hadithin e Pejgamberit a.s. dhe biografitë e këtyre as'habëve të respektuar, të cilët kanë qenë ithtarë të Dinit; e tërë kjo do ta ndriçojë shpirtin tënd dhe do ta

gëzojë zemrën tënde.

VËLLAZËRIA DHE DASHURIA E VËNË NË LËVIZJE NJERËZIMIN

Besimi përmban në vete disa përparësi. Është detyrë jona që t'ju tregojmë se çfarë përparësi dhe epërsi rrjedhin nga besimi. Njëra nga përparësitë e Islamit është, siç e dimë nga historia, se kur muslimanët e çlirojnë një vend, kanë vetëm një qëllim, e që është lavdërimi dhe madhështimi i fjalës së Zotit dhe shndritja e atij vendi me dritën e Kur'anit. Atëherë zhduken të gjitha mosmarrëveshjet, vendin e udhëheq drejtësia, dashuria dhe vëllazëria. Zhduken dallimet midis çliruesit të fuqishëm dhe të mundurit të pafuqishëm. Ata bëhen vëllezër; rritet dashuria ndër ta. Nën ndikimin e vëllazërimit islam, që rrjedh nga Kur'ani Famëlartë, idhujt e nacionalizmit dhe të racizmit shkatërrohen dhe zhduken, njësoj si shkrihet dhe zhduket akulli nga rrezet e ngrohta diellore. Luftëtarët muslimanë, para nisjes në luftë dhe para fitores, kanë qenë ashtu të edukuar saqë kanë qenë të liruar nga të gjitha paragjykimet dhe ndjenjat nacionaliste. Muxhahidi nuk lufton për shkak të armiqësisë dhe të urrejtjes, e as për dominim të një kombi mbi tjetrin. Kurdo që ai nisët në luftë, nisët vetëm për hir të të Vetmit Allah, i cili nuk ka shok.

Hadithi vijues na flet mbi njeriun, i cili lirohet nga të gjitha pasionet dhe epshet, dhe bëhet me të vërtetë i ndershëm.

Një njeri iu afrua Muhammedit a.s. dhe e pyeti:

“O i Dërguari i Zotit! Dëshira ime është që të bëj Xhihad në udhë të Zotit dhe unë kisha dashur që të më udhëzosh në disa gjëra themelore”.

I Dërguari nuk iu përgjigj. Atëherë u shpall ky ajet:

“... e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë”. (Kur’ani, 18:110)

Kur’ani e ka drejtuar këtë njeri drejt shtegut nëpër të cilin duhet shkuar. Makutëria për harxhim të kotë dhe lakmia për pushtet janë veti të egoistëve, njerëzve që nuk besojnë Allahun xh.sh. Islami ngrit shpirtin njerëzor mbi këto të meta. Ai kërkon nga njeriu që plotësisht të sakrifkohet në rrugën e idealeve. A mund të paramendohet se njeriu, të cilit Dini i urdhëron mendime të çiltëra, kontrollimin e epsheve dhe makutërive, të cilit i urdhëron Xhihad vetëm në emër të Zotit; do të mund të ndërmerre aksione në baza personale apo nacionale? Kjo, me të vërtetë, nuk mund të qëndrojë.

Njerëzit fitimtarë, të cilët me meritën e Islamit janë pasuruar me largpamësi e i njohin shtigjet e vërteta; kurrë nuk do të lejojnë që të bëhen robër të urrejtur. Çkado që kanë bërë besimtarët, e kanë bërë për levërdinë e vëllezërve të vet, me të cilët i kanë bashkuar zemrat, i kanë shkrirë shpirtërat e vet me shpirtërat e tyre, e atëherë me të drejtë kanë thënë: “Suksesi juaj është suksesi ynë, humbja juaj është humbja jonë, Libri i Lartësuar i Allahut është faktor që na ndërlidh.”

Që të dy grupet heqin dorë nga çdo gjë vetëm për idenë e vet dhe e sakrifikojnë veten në rrugën e Islamit. Sakrificat e tyre dhe lufta e tyre kishin vetëm një qëllim, e kjo është që drita e Allahut xh.sh. ta ndriçojë tërë njerëzimin dhe që dielli i Kur’anit të shtrihet mbi ta.

Për ata, të cilët e kuptojnë, kjo paraqet të mirën kulminante dhe shkallën më të lartë të përparimit.

KUFIJTË E ATDHEUT ISLAM

Epërsia e dytë e “Vëllezërve Muslimanë” është bindja e tyre se çdo musliman beson se secila pjesë e tokës e banuar me vëllezërit e tyre, ithtarët e Kur’anit Famëlartë, është pjesë e atdheut islam, në kufijtë e të cilit qëndrojnë bijtë e Islamit, muxhahidët, të gatshëm për ta mbrojtur. Dhe prandaj kufijtë e atdheut islam janë shumë të gjatë; ato i kapërcejnë barrierat geografike dhe i tejkalojnë ndjenjat nacionale. Ata kufij i përfshijnë idealet e virtytshme, besimin e çiltër e të qartë dhe të gjitha parimet islame të përcaktuara nga Allahu xh.sh. - burimi i dritës, të cilat i udhëzojnë njerëzit e mirë në rrugë të drejtë. Islami i fton të gjithë bijtë e vet në këtë rrugë, që ta kuptojnë domethënien e këtyre fakteve. Islami dëshiron ta mbjell të Vërtetën në zemrat e njerëzve. Islami ua cakton si detyrë mu’minëve që ta shuajnë shtypjen dhe dhunën, ta zgjerojnë atdheun islam dhe t’i çlirojnë të shtypurit nga kthetrat e shtypësve.

RRUGA E GJATË

Unë shpresoj se, me këtë, thirrja e “Vëllezërve Muslimanë” do të bëhet më e qartë për të gjithë dhe se qëllimet dhe synimet e tyre do të njihen botërisht. Unë tanimë kam zhvilluar bisedime të shumta të gjata mbi këto probleme, me ata vëllezër, të cilët i janë besnikë Islamit dhe të cilët e respektojnë atë.

Të gjithëve u falënderohem për vëmendjen, të cilën ia kushtuan bisedave të mia. Kalonim nga një temë në tjetrën dhe në fund shumica ishin plotësisht të kënaqur, duke bartur në zemrat e veta besimin në të Vërtetën dhe në fitoren e Islamit. Mirëpo, më befasoi fakti se disa prej tyre dyshojnë në triumfin e afërt të Islamit, duke thënë se kjo rrugë, deri te fitorja, është e gjatë dhe

se në shumicën e vendeve mbisundon civilizimi i materializmit. Hamendjet e tilla zgjojnë dyshimet. Kam frikë se edhe në zemrat e disave nga lexuesit e mi po ashtu do të paraqiten dyshime të tilla, si tek ata të cilët i përmenda më sipër. Prandaj është dëshirë imja që me bekimin e Allahut xh.sh., misioni ynë i tanishëm t'i plotësojë zemrat e tyre me shpresë dhe luftë për ngadhënjim si dhe për fitoren e kësaj ndërmarrjeje të madhe! E tërë fuqia dhe forca, për të gjitha kohët, janë vetëm të Allahut xh.sh.

FILOZOFIA E KOLEKTIVIZMIT

Tani do ta kufizojmë ligjërimin tim në dy teori.

Mbrojtësit e kolektivizmit thonë se raportet e sotme janë ëndërr e së djeshmes, ndërsa ëndrrat e sotme - realitet i së nesërme.

Këtë e arsyetojnë me fakte dhe me rezonim. Në të vërtetë, kuptimet e tilla krijojnë parakushte për ecjen e njerëzimit dhe lëvizjen e tij kah më e mira. Deri para disa vitesh, para paraqitjes së zbulimeve të reja, kush do të mund të parashikonte se shkencëtarët do të kenë aq sukses dhe se shkenca do të arrijë nivel aq të lartë? Është fakt se shumë teknologë dhe shkencëtarë i mohonin konceptet, duke mos besuar në progres, por sidoqoftë ai arriti dhe u bë evident, kështu që sot çdo diskutim për këtë do të ishte i tepërt.

TEORIA HISTORIKE

Te të gjithë popujt ka ngjarë që ecja e tyre drejt zhvillimit, në fillim të jetë e dobët dhe vëzhguesit e kanë shikuar me skepsë zhvillimin e tij. Sidoqoftë, historia tregon se përmes durimit, qëndrueshmërisë, vizionit të pjekur, tolerancës dhe qëndresës lëvizjet e dobëta në fillim shndërroheshin në suksese kolosale, të

cilat as që mund të parashikoheshin. Kush mund të paramendonte se nga Gadishulli Arab, që atëherë ishte shkretëtirë e uritur, do të përhapej pranvera e dritës dhe mësimi i Allahut xh.sh. në të gjitha anët, dhe se bijtë e Arabisë do të inspiroheshin me nxitje të atillë shpirtërore e politike, e se do ta thyenin perandorinë më të madhe botërore të asaj kohe. Dhe kush do të mund të supozonte se njeriu aq i ndjeshëm dhe i butë, siç ishte Ebu Bekër Es-Siddiku r.a., butësia dhe ndjeshmëria e të cilit ishin të njohura; do të ketë aq fuqi dhe forcë që, për një ditë, të dërgojë fuqi as më të vogël e as më të madhe, por plotë një- mbëdhjetë ushtri! Askush nuk do të mund ta paramendonte se ai do t'i thyejë tradhtarët, do t'i dënojë rebeluesit dhe kryengritësit, e do t'i pranojë të dëbuarit, të cilët vendosën që ta japin zeqatin në emër të Zotit!

E kush do të besonte se grupi i vogël i Benu Alisë dhe Benu Abazit, që deri atëherë fshehej, do ta thyejë për një çast perandorinë e fuqishme? Kush mundej ta paramendojë se Salahudin Ejubiu do të mund të qëndronte, një kohë të gjatë, në konfliktin me 25 prijësit evropianë bashkë me ushtritë e tyre superiore, e t'i dëbojë ata?

Të gjitha këto janë fakte të vërteta nga e kaluara e që vërtetojnë, për vëzhguesin inteligjent, se edhe sot e gjithë kjo është e mundshme.

A EKZISTON NDONJË RRUGË TJETËR

Nëse në rrugën tonë na kundërvihen negativitete, ne do të shkojmë me udhërrëfyesin tonë Kur'anin. Ne duhet vetëm ta zgjojmë vetëdijen. Çdonjëri duhet t'i kryejë detyrat e veta dhe të shpresojë për shpërblim nga Fuqiploti. Për lumturinë e kësaj bote,që do të vijë,meritore janë veprat e mira.

Nëse e kaloni kohën të plotësuar me vepra të mira, të jeni të sigurt se do t'i mblidhni frytet. Por nëse bini buzë greminës dhe në mosangazhim, do të bëheni të pandërgjegjshëm, persona të cilët nuk i përmbushin obligimet; shpërblimi i Xhihadit do të humbet, e ju do të jeni të privuar nga çdo e mirë:

“E kur u lexoheshin atyre ajetet Tona të argumentuara, ata që nuk kishin besuar u thoshin atyre që kishin besuar: “Cili grup (ne ose ju) ka vend jete më të mirë dhe kuvend më autoritativ?” (Kur’ani, 19:73)

Kjo temë është përpunuar me kujdes në ajetin vijues të Kur’anit Famëlartë:

“Dhe kur një grup prej tyre thanë: “Përse këshilloni një popull që Allahu do ta shkatërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër?” Thanë (këshilluesit): “Arsyetim para Zotit tuaj dhe me shpresë që t’u largohen gabimeve.” E kur braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që pengonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të fortë, ngase ishin të shfrenuar.” (Kur’ani, 7:164-165)

TREGIMI MBI KRIJIMIN E UMMETIT SHKALLA E PARË - DOBËSIA

Izraelitët kanë qenë nën sundimin e Faraonit tiran dhe arrogant, i cili i shkllavëroi shërbetorët e Allahut xh.sh., i bëri të dobët e të pafuqishëm, i shndërroi në punëtorë pa pagesë. Grupe të njerëzve të respektuar dhe fisnikë vetë u degjeneruan në robër të varur të këtij tirani të padëgjueshëm ndaj Allahut xh.sh. Dhe kur Allahu kishte për qëllim që këtij grupi t’ia kthejë lirinë e uzurpuar, nderin dhe respektin, shkëndija e parë e lirisë, që ishte shpallur solemnisht, ishte e simbolizuar në personalitetin e

udhëheqësit të madh, Pejgamberit Musa a.s., i cili atëherë ende ishte fëmijë.

“Që po t’i lexojmë ty nga lajmi rreth Musait e faraonit, e që është e vërtetë për një popull që beson. Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve. E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues”. (Kur’ani, 28:3-5)

SHKALLA E DYTË - UDHËHEQJA

Tani vijmë deri në fazën ku prijësi hyn në moshën e pjekurisë. Ai është pjekur dhe i është besuar pejgamberia. Ai ngrihet kundër shtypjes dhe persekutimit të popullit. Për ta liruar veten nga robëria, ai përshëndetet nga ia vend.

Kur Allahu i Plotfuqishëm e ngriti atë në pejgamberi dhe ia besoi përgjegjësinë që të jetë i Dërguari i Tij, ia përcaktoi detyrën e çlirimit të bashkësisë. Ky vëmendjen e vet e përqëndroi, me besim dhe fuqi të madhe, në Faraonin. Kërkoj nga Faraoni që të mundësojë liri për bashkësinë e vet dhe ta ndjek udhën e së Vërtetës që i është rrëfyer. Kur i dëgjoi këto fjalë, tirani gjakatar filloi të tallet. Për këtë Kur’ani Famëllartë, përmes fjalëve të Musasë, thotë:

“Më përmend atë të mirë që më bëre mua, e ti robërove beni israilët!” (Kur’ani, 26:22)

O tiran e persekutues! Ithtarët janë robër të Allahut e jo tuajit. A janë këto mirësitë për të cilat më përkujton? A është kjo përshtypja të cilën e ke lënë në mua? Ndërsa e vërteta është se ti e ke përlurur popullin tim në pamëshirë dhe i ke nënshtruar

ithtarët e mi.

Kjo ishte thirrje e qartë e së Vërtetës, jehona e së cilës kumbonte nga goja e Pejgamberit të shquar, i cili e tundte fronin e tiranit dhe i gërmonte themelet e shtetit të tij.

“Shkoni dhe faraonit thoni: “Ne jemi të dërguar nga Zoti i të gjitha botëve. T’i lejosh beni israilët të vijnë me ne!” Ai (faraoni) tha: “A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate. Dhe ti e bërë atë punën tënde që e bërë, pra ti je mohues (i të mirave që t’i bëmë).” (Musai) Tha: “E bëra atë, atëherë kur isha i pavetëdijshëm. Andaj, edhe ika prej jush kur u frikësova nga ju, e Zoti im më dhuroi urtësi dhe më bëri nga të dërguarit.” (Kur’ani 26:16-21)

SHKALLA E TRETË - KONFRONTIMI

E pamë se sa i egër ka qenë shteti ndaj së Vërtetës, sa agresiv ka qenë dhe si është përgatitur për ta mbytur të Vërtetën; si tenton autoriteti i pushtetit që të Vërtetën ta shtyjë në fatkeqësi dhe si përpiqet t’i shkatërrojë ithtarët e saj. Atëherë shohim përsëri se si ithtarët e së Vërtetës gu- ximshëm shikojnë tiraninë në fytyrë, ngriten kundër saj me durim dhe trimëri; si e zgjon udhëheqësi popullin, si ia zgjon krenarinë dhe si angazhohet që nga zemra e tij ta shkulë nënshtrimin dhe qyqarinë:

“Të parët nga populli i faraonit thanë: “A do të lejosh Musain dhe popullin e tij të bëjnë përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu?” Ai (faraoni) tha: “Do t’ua mbysim djemtë e do t’i lëmë të gjalla gratë e tyre për shërbim, ne jemi dominues mbi ta.” (Kur’ani, 7:127)

SHKALLA E KATËRT - LUFTA DHE BESIMI

Kur shikojmë këtë shembull të besnikërisë ndaj së Vërtetës, durimin, guximin dhe fuqinë e ithtarëve të saj, ne mahnitemi me të gjitha këto. Jeta të cilën ata e kanë zgjedhur është vetëm lufta, ndjekja e prijësit, kanosja permanente me vdekje, vetëmohimi dhe skamja bashkë me veprimet poshtëruese nga ana e mbretit tiran.

Magjistarët i thanë Faraonit:

“...Pasha Atë që na krijoi, nuk të japim përparësi ty ndaj argumenteve që na erdhën, e ti bëjë atë që mendon ta bësh, dhe mund të zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote! Ne i besuam Zotit tonë që Ai të na i falë gabimet tona dhe magjinë, me të cilën ti na detyrove. Allahu është më i miri (në të shpërblyerit) dhe më i përjetshmi (në të dënuar)!” (Kur’ani, 20:72-73)

SHKALLA E PESTË - TRIUMFI I SË VËRTETËS

Rezultati i gjithë kësaj kurorëzohet në shkallën e pestë. E dini ç’është kjo? Kjo është fitorja dhe suksesi i së mirës, kjo është fitorja e së Vërtetës; janë këto shpëtimi dhe lajmet e mira. E gjithë kjo i është caktuar njerëzisë së shtypur. Ky është shikimi në shpresën që rritet midis njerëzve. Ky është zëri i së Vërtetës që kumbon mbi tokë.

“O bijtë e israilit, ne ju shpëtuam prej armikut tuaj...” (Kur’ani, 20:80)

Përmbajtja

HASAN EL BENNA (1906 - 1949).....	2
HYRJE.....	4
KRITERI I TË GJYKUARIT.....	4
KUPTIMI I JETËS SIPAS KUR'ANIT.....	5
SI I JANË KUSHTUAR MUSLIMANËT KËTIJ QËLLIMI?.....	8
QËLLIMI ËSHTË ÇËSHTJE THELBËSORE E ME VEPRIM SHKOJMË DREJT TIJ.....	8
BAZAT E QËLLIMIT TONË.....	9
PËRFUNDIM.....	10
SI TË VIHET DERI TE PASURIA.....	11
NE DHE POLITIKA.....	12
PËRKATËSIA JONË KOMBËTARE DHE QËNDRIMI I SAJ KRYESOR.....	13
BURIMI MË I RËNDËSISHËM I FUQISË.....	15
PËRKATËSIA JONË NË IDENË.....	16
ËNDRRAT E DJESHME JANË ÇELËS I TË SOTMES.....	17
MISIONI I MUSLIMANËVE.....	18
E DREJTA E HUMANITETIT (NJERËZISË).....	19
MBROJTJA E SË VËRTETËS ME FORCË.....	20
UDHËHEQJA KRIJUESE DHE E REFORMUAR.....	22
PËR NE ËSHTË KOHA QË TË KUPTOJMË.....	24
PREJ NGA DO TË FILLOJMË.....	25
NDËRMJET DY FUQIVE.....	27
UDHA E QARTË.....	28

KURSI YNË ËSHTË DËGJUESHMËRIA	30
FRIKA NGA DEVIJIMI	31
REFORMA E LIGJIT	31
REFORMA E DEMONSTRATAVE MASIVE	32
LUFTA KUNDËR ANARKISË.....	33
EDUKIMI I ORGANIZUAR	33
PËRPARËSITË E MARRËDHËNIEVE VËLLAZËRORE	34
PAJTUESHMËRIA.....	35
VËLLAZËRIA DHE DASHURIA E VËNË NË LËVIZJE NJERËZIMIN	37
KUFIJTË E ATDHEUT ISLAM.....	39
RRUGA E GJATË.....	39
FILOZOFIA E KOLEKTIVIZMIT	40
TEORIA HISTORIKE	40
A EKZISTON NDONJË RRUGË TJETËR.....	41
TREGIMI MBI KRIJIMIN E UMMETT SHKALLA E PARË - DOBËSIA	42
SHKALLA E DYTË - UDHËHEQJA	43
SHKALLA E TRETË - KONFRONTIMI.....	44
SHKALLA E KATËRT - LUFTA DHE BESIMI.....	45
SHKALLA E PESTË - TRIUMFI I SË VËRTETËS	45